REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SPITALI RAJONAL KORCE

# PLANI I KOMUNIKIMIT 2013-2014

## PLAN PUNE

Tetor 2013

Ky publikim u mundësua nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. U pregatit nga Spitali Rajonal Korçë nëpërmjet Projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi".

Citim i rekomanduar: Spitali Rajonal Korçë nëpërmjet Projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" Tetor 2013. Plani i Komunikimit 2013-2014.

Projekti i USAID "Mbështetje Reformës në Shëndetësi" menaxhohet nga Abt Associates nën kontratën 182-C-00-10-00104-00

REFUZIM

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara

# FALENDERIME

Spitali Rajonal Korçë falenderon Ministrinë e Shëndetësisë dhe projektin "Mbështetje e Reformës në Shëndetësi" financuar nga USAID për ndihmesën e dhënë në përgatitjen e këtij plani.

Falenderohen gjithashtu gjithë anëtarët e Grupit të Punës për Marredheniet me Publikun: Gjergji Gjata, Koço Mati, Diana Aliçkolli, Viola Bezhani, Mateo Balli, Stela Guci, Vigena Plovishti, Margarita Jazxhi, Erigelda Kita, Edlira Bode që punuan për përgatitjen e këtij dokumenti kaq të rëndesishëm për mbarëvajtjen e punës së spitalit, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe rritjes së kënaqësisë së stafit dhe pacientëve.

# HYRJE

Grupi i Marrëdhënieve me Publikun i Spitalit Rajonal Korçë ka zhvilluar një Plan Komunikimi me qëllim vendosjen e mënyrave sesi informacioni do të shpërndahet brenda Spitalit Rajonal Korçë por edhe për komunitetin e rajonit Korçë ku ky spital ofron shërbime.

Ky plan komunikimi do të shërbejë si udhëzues i cili do të garantojë që informacioni do të ndahet në mënyrë:

- Të organizuar
- Efikase
- Të drejtë

Me qëllim që të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë grupet e synuara brenda dhe jashtë Spitalit Rajonal Korçë.

# PËRSHKRIMI I SPITALIT

## ORGANOGRAMA




## NGRITJA DHE FUNKSIONIMI I SPITALIT KORCE

Nga te dhenat burimore per ngritje spitalesh ne rrethin e Korces, ne vitin 1918 gjejme nismen e nje spitali me 25 shteter ku sherbenin drejtor Sotir Bilbili, mjek internist Koço Noçka, nje farmaciste dhe dy sanitare ne qytetin e Korçes. Gjate Luftes se Pare Boterore, zona e Korçes ishte e pushtuar nga ushtrite franceze dhe Korça sikurse i gjithe vendi yne ishte ne varferi dhe mjerim. Semundje si sifilizi, malaria, tuberkulozi shkaktonin vdekje te panumerta. Mjekesia ishte nje tregeti e rendomte per te zhvatur te semuret.

Ne keto rrethana si rezultat i presionit te vazhdueshem dhe perpjekjeve te perseritura te popullsise vendase u be e mundur qe ne vitin 1918 qyteti i Korçes te kete nje spital me 25 shtreter. Mbas Kongresit te Lushnjes me 1920, spitali u mor ne dorezim nga administrata e shendetesise shqiptare. Me 1922 spitali u transferua ne nje godine tjeter dhe kapaciteti i tij u rrit me 30 shtreter. Drejtor ne ate kohe u emerua Dr. Fahri Rushiti i cili ishte njekohesisht dhe kirurg i spitalit. Me pas drejtore te spitalit kane qene Dr. Sali Zavalani (prej viteve 1924-1926) dhe pas tij drejtor dhe kirurg ka qene Dr. Shyqyri Çupishti. Prej vitit 1930-1933 drejtor dhe kirurg ka qene Dr. Llambi Dardha (ne kete periudhe spitali vendoset ne ndertesen e Asim Mborjes, sa dhe sot kjo ndertese quhet "Spitali i Asimit"). Ndersa doktor Sotir Polena filloi punen si drejtor dhe kirurg me 1933. Me 1934 spitalit iu shtuan edhe disa godina te reja dhe kapaciteti i tij u rrit ne 50 shtreter, me 1936 arriti ne 70, dhe u

hap dhe nje ambulance per vizita dhe mjekime ambulante. Spitali ne ate kohe frekuentohej pak per arsye te kushteve te veshtira ne te cilat ndodhej dhe ndihmes shume te paket qe i jepej prej qeverise se asaj kohe. Aktiviteti i tij ishte shume i kufizuar duke marre parasysh se ne vitin 1934 vetem popullsia e qytetit te Korçes arrinte ne 25.000 banore dhe ky spital i sherbente gjithe qarkut te Korçes.

Ne vitin 1937, spitali i Korçes transferohet ne godinen e ish Liceut (ish godina e Sanatoriumit). Ne vitin 1938, spitali kishte nje personel prej 71 vetesh, midis tyre 9 mjeke ose nje mjek per 13800 banore, nje farmacist dhe nje ndihmes farmacist. Jeta mesatare e njeriut ishte 38.3 vjet. Gjate periudhes se Luftes Nacional Çlirimtare (1939-1944) spitali i Korçes ka funksionuar ne ilegalitet dhe ofronte me ate pak personel qe kishte ndihmen per te plagosurit e luftes.

Çlirimi i vendit e gjeti shendetesine ne gjendje te vajtueshme ashtu si gjithe sektoret e tjere te ekonomise, arsimit dhe kultures. Ne te gjithe rrethin kishte nje spital ne ish-ndertesen e Sanatoriumit me nje kapacitet prej 130 shtreterish, ku kishte perveç spitalit te patologjise dhe kirurgjise edhe infektivin (godine e vogel me vete), repartin e dermatologjise, okulistiken dhe laboratorin bakteriologjik. Kishte gjithesej nje personel prej 71 vetesh, ndermjet tyre 9 mjeke.

Ne mars te vitit 1946 spitali u transferua ne ndertesen qe ndodhet sot, kapaciteti u rrit nga 130 ne 250 shtreter duke shtuar dhe numrin e personelit te nevojshem. U krijuan perveç reparteve ekzistuese edhe reparte te tjera si ai i Pediatrise qe u sistemua ne nje godine me vete dhe me kapacitet prej 65 shtreter dhe reparti i Radiologjise. Drejtor Spitali ne ate periudhe dhe deri ne vitin1962 ka qene Dr. Sotir Polena.

Ne vitin 1946 u hap per here te pare dhe reparti i lindjes ne nje ndertese te veçante ne afersi te spitalit. Ne fillim kapaciteti ishte 15 shtreter por gradualisht erdhi duke u shtuar dhe forcuar per te plotesuar nevojat gjithnje ne rritje te popullsise per kete sherbim.

Veçanerisht kujdes i madh iu kushtua ne ato vite luftimit te semundjeve ngjitese dhe sidomos semundjeve tuberkulare dhe u hap qysh ne vitin 1946 Sanatoriumi i Korçes me kapacitet deri 400 shtreter i cili dha nje kontribut shume te madh ne sherbimin e mjaft te semureve tuberkulare te rrethit te Korçes por edhe te rretheve fqinje.

Ne vitet ne vazhdim, dhe konkretisht ne vitin 1961 u hap reparti i ORL-se me 20 shtreter dhe me 1962 reparti i Neurologjise me 20 shtreter. Ne vitin 1965 spitalit iu shtua reparti i Anatomise-Patologjike i cili se bashku me gjithe sherbimet e tjera ndikuan ne rritjen e metejshme te cilesise se sherbimit ndaj popullise se Korçes. Ne keto vite u rrit shume aktiviteti i spitalit dhe sherbimi shendetesor ne teresi ku vetem ne Polikliniken e Korçes, me 1963 u regjistruan 43000 te semure dhe ne pediatri 31000, drejtor spitali ne vitet 1962-1963 ka qene Dr. Ilia Papakozma, ndersa ne vitin 1967 ka qene V.Visi (8 muaj).

Me 1973 u hap spitali pediatrik me 200 shtreter ndersa Drejtor Spitali ka qene J. Vreto 1967-1975. Ne vitet 1975-1986 drejtor spitali ka qene K.Pallanguri, dhe prej viteve 1986-1990 ka qene drejtor spitali Dr. Gaqo Kane dhe zv/drejtor Petrit Buletini.

Nga viti 1991-1992 drejtor spitali ka qene Dr. Ahmet Dulellari, Dr Piro Pine ka drejtuar Spitalin e Korçes per periudhen 1992-1996, Dr. Dhimitraq Papapando per vitet 1996-1997, Dr. Arben Anastasi ne vitin 1997, Dr. Ahmet Hoxhallari 1997-2005, Dr. Viollandi Remacka ka drejtuar spitalin per periudhen 2005-2006, me pas Drejtor ka qene Ilia Jatagani 2007-2008, Dr. Gjergji Denasi 2008-2009. Dr. Mishel Papakozma 2009-2011, Riza Ashimi 2011-2012, Dr. Artan Buzo 2012-2013 dhe aktualisht drejtor i spitalit te Korces eshte doktor Ylli Qirinxhi (Prill 2013).

Perpara viteve '90 spitali i Korçes kishte 760 shtreter. Ne keto vite, per te rritur cilesine e mjekimit dhe asistences mjekesore ndaj te semureve ne institucionet e mjekimit ne rrethin e Korçes u hapen perveç sherbimeve te semundshmerise interne, te kirurgjise, te neurologjise, te dermatologjise, te infektivit, te otorino-laringologjise, okulistikes dhe specialitetet dhe nenspecialistet e tjera te nevojshme kemi rritje te games se ekzaminimeve te suksesshme si bronkografia, mielografia, EKG, cigloergometria, monitorizimi, ekzaminimi radiologjik dhe ekzaminimet laboratorike, etj. Gjithashtu kemi funksionimin e bllokut operator, repartit te reanimacionit polivalent prane sherbimit te kirurgjise, repartet e terapise intensive, dhe repartin e reanimacionit prane spitalit pediatrik.

Nr i shtreterve perpara vitit 2010 ka qene 618 dhe 619 ka qene numri i personelit te punesuar nderkohe qe aktualisht spitali i Korçes ka nje kapacitet prej **510** shtreterish dhe **589** te punesuar. Spitali i Korçes mbulon nje popullsi prej **220.438**[1] banoresh (qe perfshin 4 rrethet e prefektures Korçe). Shifra e shfrytezimit mesatar te shtratit per vitin 2012 ishte **45,3%** nje realizim i indikatorit te performances shume pozitiv krahasuar me vitet e kaluara.

Ne vitin 2004 perfundoi rikonstruksioni i kampusit qendror te spitalit (u rikonstruktuan dhe u pajisen sallat e kirurgjise, reparti i terapise intensive, reparti i kirurgjise se pergjithshme, reparti i urgjences, kardiologjise dhe semundjeve te brendshme) financim i kryer me fondet e qeverise shqiptare ndersa godina e pediatrise u rikonstruktua me Fondet e Kryqit te Kuq Gjerman, ne vitin 2001.

Investime ne infrastrukture jane kryer dhe ne godinen e Poliklinikes se Specialiteteve dhe konkretisht 558.780 Euro u perdoren per rehabilitimin fizik te perfunduar ne vitin 2012 duke krijuar kushte mjaft te mira infrastrukturore per ofrimin e sherbimit cilesor.

Permiresimi i kuadrit rregullator ne drejtim te organizimit, menaxhimit, decentralizimit dhe autonomise, mekanizmit te financimit te sherbimeve shendetesore, si dhe forcimit te kapaciteteve te burimeve njerezore, ashtu si ne gjithe vendin, edhe ne Spitalin Rajonal te Korçes, ne te cilin vetem per vitin 2012 jane trajtuar rreth **25.000** paciente dhe ku ofrohen gjithe sherbimet e percaktuara per nje spital rajonal (gjithesej 12 sherbime), eshte shoqëruar me shume investime te tjera ne infrastrukture dhe pajisje mjekesore, te realizuara ne kete spital si:

- Ndertimi dhe venia ne funksionim e ngrohjes qendore
- Instalimi dhe venia ne funksionim i mamografit ne Polikliniken e Specialiteteve
- Instalimi dhe trajnimi i stafit te Autoklavit per mbeturinat spitalore
- Perfshirja nder spitalet e para te ngritjes se Telemjekesise
- Perfshirja ne tre spitalet pilote ne Shqiperi ne projektin "Ne Mbeshtetje te Reformes ne Shendetesi" financuar nga USAID

## SHERBIMI I SEMUNDJEVE TE BRENDSHME

Mbas çlirimit te vendit, permiresimi i gjendjes ekonomike dhe zhvillimi kulturor solli permiresimin e gjendjes shendetesore te popullit shqiptar. Mjekesia tashme ka karakter social dhe u ngjit ne rangun e nje shkence humanitare ne kuptimin e vertete te fjales. Filluan te organizohen dhe higjiena dhe profilaksia. Ne repartin e semundjeve te brendshme sikurse quhej ne ate kohe fillojne punen mjeket Vasil Tomco i cili ishte dhe shef i repartit me pas Koco Lubonja (1948-1952). Mbas celjes se Institutit te Pare te Larte Mjekesor ne Tirane me 1952, ne repartin e patologjise vijne mjeket Dhimiter Sofroni, Namik Kasimati dhe Dr. Misto Nuke i cili drejton sherbimin deri me 1967. Ne vitin 1965 vjen Dr. Haki Zyfi i cili drejton sherbimin nga vitet 1969-1971. Ne vitin 1971 merr drejtimin e repartit Dr. Mico Llapushi i specializuar per terapi te pergjithshme. Nen drejtimin e tij sherbimi u ngrit ne nje nivel shkencor me te larte, shtohen konsultat e te semureve rende dhe vizitat e perbashketa. Ne vitin 1981 shef reparti filloi dr. Ligor Shkrapi. Reparti punonte me 90 shtreter.

Per te rritur me tej cilesine e sherbimit u pa e nevojshme ndarja e nenspecialiteteve te semundjeve te brendshme, i Kardiologjise me 1961 me kabinet te vecante i celur nga Dr. Misto Nuke, me pas vjen Dr. Namik Kasimati qe punoi si shef i sherbimit prej vitit 1967-1968. Me 1983 ne repartin e Kardiologjise fillojne punen mjeket Pellumb Bregu dhe Ilia Skendi i cili drejton aktualisht Repartin e Kardiologjise prej vitit 1992.

Dr. Ilia Skendi ka kryer per here te pare defribilimin elektrik dhe monitorimin e te semureve me infarkt miokardi.

Sherbimi i endokrinologjise u cel me 1973 nga Dr. Engjell Gusho. Me 1984 i shtohet ketij sherbimi Dr. Piro Pine i cili aktualisht drejton kliniken e Semundjeve te Brendshme prej vitit 2003.

[1] Burimi: INSTAT (Census, Tetor 2011)

Sherbimi i alergologjise celet me 1973 nga mjeku Ligor Shkrapi. Filloi desensibilizimi specifik i te semureve alergjike dhe mjekimi me metoda bashkekohore. Sot, mjek alergolog eshte Dr. Sokol Agolli.

Sherbimi i reumatologjise celet ne vitin 1975 nga dr. Sotiraq Furxhi.

Sherbimi i nefrologjise filloi punen ne vitin 1975 nga Dr. Mustafa Shukulli.

Sherbimi i hematologjise filloi punen me 1975 nga Dr. Stavri Prifti. Hyri ne perdorim te gjere mielograma, biopsia dhe perdorimi preparateve citostatike per te semuret me semundje gjaku. Sot mjeke hematologe eshte Dr. Gerla Koleci.

Sherbimi i semundjeve profesionale hapet me 1978 nga Dr. Ligor Shkrapi. Filloi ne kete kohe studimi dhe depistimi i pneumokonjazave dhe intoksikimeve profesionale. Behet gjithashtu ndjekja profilaktike e punonjesve qe jane nen ndikimin e faktoreve demtues profesionale.

Sherbimi i gastroenterohepatologjise celet me 1979 nga Dr. Zana Treska. Ne bashkepunim me kliniken universitare futen metoda te reja diagnostikuese si ekografia, fibrogastroskopia, shintigrafia e heparit, etj.

Reparti i Infektivit ne vitin 1945 u sistemua ne nje nga pavionet e spitalit me 25 shtreter. Me pas u transferua tek godina ku sot ndodhet Sherbimi i Semundjeve te Mushkerive, ne fillim me 25 shtreter dhe shume shpejt kapaciteti do te arrinte ne 50 shtreter. Gjate kesaj periudhe, sherbimi mjekesor eshte kryer nga Dr. Ilia Ballauri, Niko Jasi dhe Dr. Pateli. Deri ne vitin 1960, reparti i Infektivit ka qene i inkuadruar ne repartin e Patologjise te spitalit. Shef i repartit te Patologjise ku benin pjese dhe shtreterit e infektivit ka qene Dr. Koco Lubonja. Nga viti 1954-1955 shtreterit e ketij reparti drejtoheshin nga Dr. Misto Nuke, ndersa nga viti 1955 shtreterit e repartit te infektivit drejtoheshin nga Dr. Koco Lubonja. Nga viti 1960, reparti i infektivit eshte ndare nga patologjia si repart me vehte dhe ka funksionuar me nje kapacitet prej 50 shtreter. Pergjegjes ka qene Dr. Koco Lubonja. Ne kete repart kane punuar mjeket Th. Stratoberdha, Sh.Themeli dhe Svetllana Marashi. Reparti i Infektivit sot drejtohet nga mjekja Ornela Ruco.

Ky repart ka perballuar me sukses semundshmerine infektive jo vetem te rrethit Korce, por edhe te rretheve Pogradec dhe Erseke, te cilat nuk kishin sherbim te semundjeve infektive deri ne mes te viteve '80.

Reparti i dermatologjise nga 4-5 shtreter ne 1953 u rrit ne 20 shtreter me ardhjen e mjekeve te rinj dermatologe si Jani Shano dhe Llazi Pantazi.

## SHERBIMI I KIRURGJISE

Deri ne fund te shek XIX si per gjithe Shqiperine edhe ne Korce kirurgjia ishte ne dore te Xheraheve dhe berbereve, kurse per anestezi as qe behet fjale sepse anesteziologjia eshte nje specialitet relativisht i ri qe ka fillimin shume vone. Historiku i kirurgjise ne Korce fillon ne Luften e Pare Boterore ne vitin 1916 me Dr. Kostandin Polena i cili praktikonte kirurgjine e vogel. Me vone do te sherbenin si kirurge Doktori Patolog Sotir Bilbili, Dr Fari Rushiti, Dr. Shyqyri Cupiti, Dr. Llambi Dardha, Dr Sotir Polena i cili punoi si drejtor deri me 1962 dhe si kirurg i spitalit te Korces deri sa doli ne pension me 1966. Me kete mjek lidhet pjesa me e madhe e historise kirurgjikale te Korces. Nje aktivitet te madh Dr. Polena ka dhene dhe ne tekniken operatore, ne operacione te ndryshme; numerohen me mijera operacionet e tij te kategorive te ndryshme.

Ne vitin 1965, vjen Dr. Mitro Tasho dhe ne vitin 1964 perdoret per here te pare narkoza me eter me aparat narkoze duke derguar per tu pergatitur ne Tirane, Llambi Zoton. Me daljen ne pesion te Dr Polenes me 1966, shef i repartit behet Dr. Lonka qe vazhdoi deri me 1976. Prej vitit 1977 dhe deri ne vitin 1990 dhe me vone ne vitet 1998-2003 shef i repartit ka qene dr. Ahmet Dulellari. Dr. Dulellari ka qene dhe shef i Sherbimit te Kirurgjise per vitet 2004-2005. Me ardhjen e ketij mjeku puna ne repartin e Kirurgjise u ngrit ne nje nivel te larte duke dhene nje kontribut te rendesishem ne persosjen e teknikave operatore. Ne vitin 1973 ne repartin e Kirurgjise filloi punen mjeku kirurg Dr. Ahmet Hoxhallari i cili ka qene drejtues i spitalit (1997-2005) dhe shef i sherbimit per vitet 1990-1992. Dr. Hoxhallari ishte i specializuar per urologji dhe me ardhjen e tij filloi te zgjerohet gama e operacioneve urologjike. Sot prane ketij reparti punojne mjeket Piro Mosko, Bujar Isak (i cili ka qene dhe shef i repartit per vitet 1992-1996, 2003-2006, shef sherbimi i Kirurgjise per vitet 2006-2009 dhe

2012), Vangjush Kostandin, Ekaterina Koblara, Niko Nunka (i cili ka qene i pari qe ka prezantuar endoskopine kirurgjikale dhe kirurgjine laparoskopike), Stefan Faberi, Roland Cule, dhe Dr. Ilia Stefo qe eshte aktualisht Shef i Sherbimit te Kirurgjise.

Ne vitin 1974 ne repartin e Kirurgjise te Korces vjen per here te pare mjeku anesteziolog Dr. Rahmi Dalipi i specializuar ne Tirane me te cilen lidhet ecuria e anestezise dhe e reanimacionit ne repartin e Kirurgjise se Korces. Qe ne kete vit, anestezia ne repartin e reanimacionit vendoset ne kushte shkencore. Aktualisht si mjeke anestezite reanimatore punojne Dr. Gjergji Sarolli, Dr. Thomaq Manika dhe Dr. Bashkim Ibi.

Ne vitin 1975 specializohet Dr. Mitro Tasho per ortopedi dhe traumatologji dhe me ardhjen e tij filluan ne seri dhe ne nje game te gjere osteosinteza dhe operacionet ortopedike duke u aplikuar per here te pare osteosintezat e frakturave. U hap nje repart i vecante i ortopedise me 20 shtreter. Ne vitin 1983 filloi punen mjeku i specializuar per ortopedi traumatologji Dr. Misto Lolo i cili per here te pare ne kete vit beri osteotomine pelvike. Aktualisht si mjeke ortopede punojne Dr. Koco Mati dhe Dr.Gjergji Dhimitri.

## SHERBIMI I SEMUNDJEVE TE MUSHKERIVE

Ne baze te dokumentacionit qe disponohet sanatoriumi i Korces i hapur me 1946 me kapacitet 200 shtreter ishte i ndare ne 134 shtreter per burra dhe 66 per femra. Keto ishin te vecanta dhe ata qe ishin me BK pozitiv ishin neper pavione te vecanta. Nga ana tjeter, funksiononte ne sanatorium edhe ambulanca antituberkulare e ngritur me 1948, fillimisht me 20 shtreter dhe shume shpejt me 50 shtreter per arsye te popullates se gjere qe mbulonte (gjithe prefektura e Korces), ku beheshin vizita klinike, kontrolle te ndryshme dhe manipulime. Ne vitet 1946-1947 drejtor i sanatoriumit ka qene Dr. Dhimiter Lito, ndersa ne vitet 1947-1951 ka qene Dr. Ludovik Kolmani, me 1957-1958 dr. Taqi Skeni, 1958-1962 Dr. Ilia Papakozma, me pas sherbimi u inkuadrua nen drejtimin e spitalit. Ne spital kane punuar Dr. Zef Kaculini 1953-1971, Dr Kanani 1960-1965, Vasil Koruni, Nesti Dhamo, Lirika Thimi, Dr Kokoneshi, Dr. Piluri, Dr. Thoma Nini, Dr. Luan Dyrmishi, Dr. D. Alickolli qe drejton aktualisht sherbimin e Semundjeve te Mushkerive prej 2005-2013.

Ne fund te vitit 2012, Sherbimi i Semundjeve Pulmonare dhe Dispanceria u zhvendos ne godinen e rikonstruktuar brenda kampusit qendror te spitalit, rikonstruksioni i kesaj godine kishte perfunduar ne vitin 2009 dhe u krye me nje fond prej 41.4 milione lekesh nga buxheti i shtetit.

## SHERBIMI I ORL DHE OKULISTIKES

Sherbimi i ORL-se i perket periudhes se pas clirimit si nje sherbim i kualifikuar dhe kompentent. Persa i perket ndihmes kirurgjikale ato trajtoheshin nga kirurgu Dr. Polena, ndersa ne vitet '40-'50 nje pjese e semundshmerise te otorino-laringologjise trajtoheshin nga Dr. Napucja. Ne vitin 1961 vjen mjekja otojatre Marika Bellovoda dhe ne kete periudhe prane spitalit brenda repartit te Kirurgjise u aprovuan 20 shtreter te ORL-se me shef Dr. Polenen. Operacionet si tonsilektomi, superacionet e sferese se ORL-se beheshin dhe behen aktualisht ne sallat e kirurgjise. Ne vitin 1966 sherbimi i ORL-se u shkeput gna kirurgjia dhe bashke me Okulistiken krijuan nje pavion me vete, sikurse ekziston dhe sot. Ne vitet 1970-1971 vjen nje mjeke e dyte otojatre Dr. Viku Gjini dhe sherbimi i ORL-se u forcua me shume duke u shtuar numri dhe llojshmeria e nozologjive qe trajtoheshin. Me ardhjen e doktor Maksim Lubonja ne vitin 1975, ai ka qene shef i repartit per periudhen 1987-1992 dhe per vitet 1997-2013, u trajtuan konservatorisht dhe me rruge kirurgjikale shume semundje qe trajton dhe ORL-ja bashkekohore.

Ndersa per problemet e Okulistikes mbas clirimit te vendit eshte marre Dr. Velo pa perjashtuar edhe mjeke te tjere patologe dhe kirurge. Ne spital te semuret me patologji te syrit, shtroheshin ne reparte te tjera si psh ne Kirurgji. Ne vitin 1963 me ardhjen e mjekut Okulist Gjergji Cepa filloi trajtimi i te gjithe urgjencave okulistike. Ne vitin 1966 sherbimi i okulistikes bashke me ORL-ne shkeputet ne repart me vehte. Ne kete repart kane punuar mjeket Zhani Mosko, Shefqet Malollari, Agron Kurro, dhe Eva Koca. Ne kete repart jane krijuar dy salla operacioni te pajisura me mjetet e nevojshme per operacion. Reparti funksionon me 15 shtreter dhe ka nje bashkepunim te mire me repartet e tjera si kirurgji, neurologji, kardiologji, etj.

## SHERBIMI PEDIATRIK

Fillimet e sherbimit pediatrik i gjejme ne vitin 1948 kur ne repartin e Kirurgjise funksiononin 4 shtreter per trajtimin e femijeve te semure ku punoi per disa vjet mjeku pediater Konstandin Kauri. Ne vitet 1950-1952 numri i shtreterve per femijet e semure ne kete repart u rrit ne 20. Ne vitin 1955 nga nevojat ne rritje per kete sherbim, numri i shtreterve u rrit perseri ne 40 dhe ne kohen e veres shtreterit shtoheshin me shume.

Ne vitin 1960 sherbimi pediatrik mori fizionomine si repart i vecante me 65 shtreter ku sherbenin 3 mjeke dhe 6 infermiere. Ne vitin 1973, sherbimi i pediatrise kishte 200 shtreter. Gjate ketyre viteve te funksionimit, spitali ka patur repartet e reanimacionit, te prematurances se traktit gastro-intestinal, ate pulmonar dhe infektiv. Nga viti ne vit per te rritur cilesine e sherbimit ndaj femijeve te semure u krijuan specialitete per kardiologjine, nefrologjine, neurologjine, infektivin, etj.

Sherbimi pediatrik ne spital ka ardhur nga viti ne vit duke u forcuar. Kontribut te rendesishem nga pikepamja organizative ka dhene Dr. Katerina Tabllo qe filloi drejtimin e institucionit prej vitit 1973 deri ne vitin 1981. Me pas e njejta gje mund te thuhet per mjekun Nesti Cekrezi qe filloi drejtimin e institucionit nga viti 1981 deri ne vitin 1992. Prej vitit 1992 deri 1994 shef i sherbimit ka qene Dr. Niko Bulka. Dr. Zydi Xhomo drejtoi repartin e reanimacionit nga viti 1973 deri ne vitin 1988, ndersa Dr. Zhani Poda drejtoi repartin e infektivit nga viti 1973-1982. Pas tij repartin e drejtoi Mjekja Viollandi Remacka e cila ka drejtuar dhe sherbimin e pediatrise nga viti 1994-1999. Ne vitin 1966, filloi pune mjekja Liri Kereku, pediatre e pare e cila prej vitit 1974 drejtoi repartin e Kardiologjise. Ne sherbimin pediatrik kane punuar dhe mjeket Zhani Babliku e specializuar per neurologji, Dr. Uljana Lekbello qe ka punuar ne reanimacion dhe me pas ne repartin gastrointestinal, Mjekja Elvira Popllo e specializuar per nefropediatri dhe qe ka drejtuar kete repart. Sot aktualisht Dr. Luan Belortaja drejton sherbimin e pediatrise prej vitit 1999.

## SHERBIMI RADIOLOGJIK

Me problemet radiologjike jane marre mjeket ftiziater, ndersa aktiviteti i mirefillte i ketij reparti filloi ne muajin janar te vitit 1945 nga mjeku Vasil Tomco, i cili punoi deri ne Janr 1960 si mjek patolog dhe radiolog ne institucionin Spital-Poliklinike. Fill pas tij, filloi punen Dr. Anastas Shore deri ne kohen qe doli ne pension. Ne vitin 1965-1970 u emeruan mjeket Ida Polena dhe Ilia Pecani. Ne vitet '80-'90 kemi mjeket Maqo Andoni, Ilir Koroveshi, dhe me pas ne vitet 2000 eshte doktor Gjergji Denasi qe eshte emeruar dhe shef i ketij sherbimi prej vitit 2012. Ne kete repart jane kryer dhe kryhen ekzaminime te ndryshme diagnostike, duke perfshire dhe ekzaminimet tomografike dhe skanerin.

## SHERBIMI NEUROLOGJIK

Ne vitet e para pas clirimit te semuret nervore trajtoheshin ne repartin e patologjise ndersa ata psikike dergoheshin ne Vlore ose ne Tirane.

Me 1 Gusht 1962 per here te pare ne rrethin tone u krijua ne spital sherbimi i neurologjise si repart me vehte me nje mjek neuropsikiater te specializuar Dr. Dhimitraq Mitrushi dhe dy infermiere. Per rreth 5 vjet reparti punohej me 20 shtreter. Me 1968, repartit iu shtuan dhe 5 shtreter gjithashtu u shtua dhe personeli i mesem. Ne vitin 1970 erdhi mjeku neuropsikiater Gaqo Kane dhe prej asaj kohe reparti rritet me 30 shtreter. Ne vitin 1979 vjen mjeku i trete neuropsikiater Petraq Pipa, me vone kemi mjeket Llambi Cikopani dhe Ralf Bitri.

## SHERBIMI OBSTETER-GJINEKOLOGJIK

Me 1946 inagurohet materniteti i pare i rrethit ne godinen e ish-repartit infektiv. Ishte repart i spitalit me shef dr. Ivzi Kasimati. Ketu trajtoheshin patologjite e barres per repartin obstetrikal dhe te porsalindurit. Interventet kirurgjikale dhe abortet kryheshin ne repartin e Kirurgjise te spitalit nga Dr. Polena.

Ne vitin 1960 u hap materniteti ne godinen e ish repartit te neurologjise. Ne kete maternitet pervec problemeve te obstetrike-gjinekologjise trajtoheshin dhe patologjite gjinekologjike, abortet, ishte dhe salla e operacionit dhe aparaturat dhe personeli i nevojshem.

Shtimi i rasteve te trajtuara qe solli shtrimet mbi planifikim krijoi domosdoshmerine e ndertimit te nje godine te re me kapacitet me te madh e cila u inagurua ne vitin 1964 me 100 shtreter (60 obstetrike dhe 40 gjinekologjike) me repartin e neonatologjise me 40 shtreter, salla operacioni dhe gjithe anekset e duhura te pajisura me aparaturat e kohes dhe personelin e duhur. Drejtor i pare ishte Dr. Kristaq Nuci, kurse ne vitin 1965 emerohet Dr. Gaqo Pulluqi. Me pas numri i mjekeve dhe personelit tjeter infermieror erdhi duke u shtuar. Permendim mjeket A. Themeli, Gj. Theodhosi, F. Karanxha, N. Gurllari, A. Polena, P.Koci, I. Beri, I. Karanxha, M. Papakozma, Gj.Gjata, R. Galica, M. Jani, A. Ikonomi.

Ne vitin 1973 u hap reparti i prematurances me 30 shtreter femijesh me aparatura dhe ambiente perkatese dhe personelin e nevojshem. Ne vitet me vone ne kete repart filluan punen Dr. K. Kasimati, Dr. M. Lubonja, mjeket neonate E.Nence, R. Ibi, dhe E. Kollcinaku.

## OBJEKTIVAT DHE PLANI I KOMUNIKIMIT

Plani i komunikimit të Spitalit rajonal Korçë do të informojë punonjësit e institucionit si dhe aktorët e tjerë jashtë institucionit, shoqërinë civile si dhe komunitetin e rajonit Korçë për:

- Nryshime strategjike të Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit të Shëndetit Publik, Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe ndryshime të tjera që sjellin ndryshime në vijueshmërinë e punës së SRK-së por edhe ndryshime që ndodhin brenda Spitalit Rajonal Korçë.
- Ndryshime të rëndësishme në Kujdesin Shëndetësor.
- Probleme që kanë lidhje me ndryshime të nevojshme.
- Ndryshime/ zhvillime të ndryshme që mund të ndodhin në Spitalin Rajonal Korçë. Politika të reja etj.
- Shërbime të reja që orfrohen në Spitalin Rajonal Korçë.

## MISIONI DHE VIZIONI

### MISIONI I SPITALIT RAJONAL KORÇË

Spitali rajonal Korçë është i përkushtuar t'i ofrojë shërbime cilësore banorëve të rajonit të Korçës si dhe zonave përreth duke përdorur njohuri e aftësi të kohës, praktikat më të mira dhe teknologji të përparuar.

**Misioni i spitalit** është të nxisë dhe përkrahë ndryshimin dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj pacientit të ofruara në Spitalin Rajonal Korçë (SRK). Të diagnostikojë, të trajtojë dhe t'i shërbejë pacientit si dhe ta edukojë atë për një jetë të shëndetshme.

Qëllimi ynë final është që të arrijmë rezultatet më të mira për të gjithë pacientët që përfitojnë nga shërbimet tona, duke u shndërruar në të njëjtën kohë dhe në qendër trajnimi model për sistemin tonë shëndetësor.

**Spitali Rajonal Korçë përpiqet të jetë një organizatë ku punonjësit gëzojnë mjedisin e tyre të punës duke arritur rezultate sa më të mira. Ne gjithashtu duam që të jemi një vend ku komunikimi është i hapur dhe transparent në të gjitha nivelet.**

### VIZIONI I SPITALIT RAJONAL KORÇË

Spitali Rajonal Korçë do të përmirësojë gjendjen shëndetësore të popullatës duke integruar në mënyrën më efikase shërbimet dhe duke siguruar një bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë shëndetësorë në nivel qendror dhe lokal si dhe partnerët tanë të shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm që zhvillojnë aktivitetin e tyre në rajonin e Korçës.

## VLERAT E SPITALIT RAJONAL KORÇË

Në Spitalin Rajonal Korçë ne vlerësojmë:

- Kujdesin ndaj pacientit

- Përkujdesjen, Sjelljen dhe Integritetin
- Respektin
- Sigurinë e pacientëve dhe punonjësve
- Cilësinë e punës
- Ndryshimet kulturore

## QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Objektivat e përgjithshem të spitalit janë:

- Përmirësimi i mënyrës së ofrimit të shërbimeve nëpërmjet zbatimit dhe përmirësimit të standarteve mjekësore,
- Rritje e aksesit të popullatës në përfitimin e shërbimeve,
- Ofrimi cilësor i shërbimeve,
- Zgjerimi i gamës së shërbimeve të ofruara nga spitali,
- Ngritja dhe funksionimi i sistemit të kompjuterizimit të të dhënave të pacientëve,
- Trajtimin e të sëmurëve në përputhje me etikën, standartet, Upk-të, protokollet e diagnostikimit dhe mjekimit dhe sistemin e referimit të miratuar nga MSH dhe Urdhërat e profesionistëve të përcaktuara me ligj,
- Përmirësimin e infrastrukturës me qëllim rritjen e aksesit dhe ofrimit cilësor të shërbimit dhe përmirësimin e kushteve të punës së personelit,
- Realizimin e indikatorëve të aktivitetit të shërbimit me qëllim përmirësimin e performancës dhe cilësisë së shërbimit dhe përfitimin e incentivave për personelin në funksion të rritjes së motivimit të tij,
- Rritje të transparencës dhe përgjegjshmërisë për menaxhimin dhe administrimin e duhur të burimeve financiare dhe humane me qëllim rritjen e kredibilitetit dhe imazhit të spitalit dhe besueshmërisë së popullatës,
- Komunikimi i rritjes së cilësisë tek komuniteti dhe edukimi i pacientit/klientit,
- Edukimi i vazhduar profesional i personelit mjekësor dhe zbatimi i kodit të etikës dhe deontologjisë nga stafi i spitalit me qëllim ngritjen dhe përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre për ofrimin e një shërbimi sa më të kualifikuar dhe kompetent,
- Përmirësimi i proçesit të buxhetit dhe rritjen e të ardhurave dytësore në kuadër të rritjes së shkallës së autonomisë së spitalit.

## OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË SPIALIT RAJONAL KORÇË - QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT 2013 – 2014

### QËLLIMI 1 - ZHVILLIMI I NJË KULTURE TË SHËRBIMIT CILËSOR

Objektivat:

- Drejtuesit e Spitalit Rajonal Korçë do të promovojnë një ambient i cili favorizon cilësinë
- Mbështetje e Komitetit të Cilësisë
- Hartimi i një plani pune në funksion të promovimit dhe mbështetjes së cilësisë në Spitalin Rajonal Korçë

### QËLLIMI 2 - RRITJA E KËNAQËSISË SË PACIENTËVE TË SPITALIT RAJONAL KORÇË

Objektivat:

- Hartimi i një pyetësori i cili mat/vlerëson kënaqësinë e pacientit

- Krijimi i procedurave për të gjithë procesin e monitorimit të pyetësorëve të kënaqësisë së pacientit (personat përgjegjës, shpërndarja, mbledhja e informacionit, frekuenca, dhe drejtimi i ankesave tek personat/departamentet përkatëse, analizimi dhe zgjidhja e problematikave dhe informimi i pacientëve mbi zgjidhjet e dhëna)
- Monitorimi i vazhdueshëm i shpërndarjes së pyetësorit, rritja e numrit të pyetësorëve të plotësuar.
- Sigurimi i një proçesi të ndershëm dhe të barabartë për trajtimin e problematikave.
- Bashkëpunimi me PAO
- Ngritja e kapaciteteve brenda spitalit për vijueshmërinë me efiçiencë të PAO-s
- Hartimi dhe zbatimi i setit të Standarteve të Kujdesit ndaj Pacientit/Klientit
- Përgatitja dhe shpërndarja e një Guide "Shërbimi i Ekselencës – Standartet e Sjelljes – Spitali Rajonal Korçë". Kjo guidë do të shërbejë si referencë për çdo punonjës

**QËLLIMI 3 - SPITALI RAJONAL KORÇË TË SHNDËRROHET NË NJË INSTITUCION MODEL QË PROMOVON VLERA**

Objektivat:

- Krijimi i një pyetësori për kënaqësinë e punonjësit dhe analizimi i të dhënave
- Mbështet planin e Burimeve Njerëzore
- Krijimi i një liste me nevojat e trajnimeve
- Forcimi dhe mbështetja, promovimi i trajnimeve
- Sigurimi i një marrëdhënie të fortë midis partnerëve të brendshëm dhe të jashtëm
- Promovimi dhe inkurajimi i vazhdueshëm i nismave për sigurinë e pacientëve dhe punonjësve.

**QËLLIMI 4 - PROMOVIMI I SITEMEVE TË INFORMACIONIT**

Objektivat:

- Mbështet planin e implementimit të sistemit të informacionit
- Mban punonjësit të informuar mbi rëndësinë dhe forcon marrëdhëniet me dy spitalet e tjera pilote SRL dhe SUOGJ.
- Mbështet me materiale komunikuese për sistemin e informacionit për punonjësit dhe pacientët.
- Punon për promovimin e rezultateve pozitive në mediat lokale sesi kompiuterizimi i të dhënave të pacientëve përmirëson aksesin dhe cilësinë e shërbimit.

**QËLLIMI 5 - RRITJA E STANDARTEVE TË HIGJENËS DHE PASTËRTISË NË SPITAL DUKE MBËSHTETUR DHE PROMOVUAR NJËSINË E SHËRBIMEVE MJEDISORE**

Objektivat:

- Mbështet dhe promovon planin e Njësisë së Shërbimeve Mjedisore si brenda dhe jashtë SRK-së.
- Ideon, prodhon materiale komunikuese brenda SRK-së për ndërgjegjësimin, rritjen e informacionit.
- Inicion, organizon, seanca informimi dhe trajnimi
- Rrit imazhin e SRK-së duke promovuar punën e Njësisë së Shërbimeve Mjedisore

**QËLLIMI 6 - RRITJA E AFTËSIVE KOMUNIKUESE TË STAFIT MES KOLEGËVE, KOMUNIKIMIN OFRUES SHËRBIMI: PACIENT DHE/OSE VIZITOR DHE KOMUNIKIMIN ME KOMUNITETIN NË TËRËSI**

Objektivat:

- Trajnimi i stafit të spitalit në lidhje me parimet e kujdesit ndaj klienit/pacientit.
- Hartimi dhe zbatimi i setit të Standarteve të Kujdesit ndaj klientit/pacientit

- Përgatitja dhe shpërndarja e një Guide "Shërbimi i Ekselencës – Standartet e Sjelljes – Spitali Rajonal Korçë". Kjo guidë do të shërbejë si referencë për çdo punonjës
- Monitorimi i zbatimit të setit të Standarteve të Kujdesit ndaj pacientit
- Promovimi i shembujve pozitive në median lokale, shkëmbimi i eksperiencave me dy spitalet e tjera pilote SRL, SUOGJ.

### QËLLIMI 7 - ORGANIZON FUSHATAT E INFORMIMIT PËR MIRËMENAXHIMIN E VIZITORËVE

Objektivat:

- Hartimin dhe zbatimin e një plani të detajuar për të mbështetur funksionimin e suksesshëm të sistemit të mirëmenaxhimit të vizitorëve.
- Informimin e brendshem të stafit me anë të sesioneve informuese/ mbledhjeve të stafit, e-maile/sms etj.
- Trajnimi e stafit për funksionimin e VMS-së dhe Etikën e Komunikimin
- Informimin e pacientëve dhe komunitetit
- Prodhimi i shenjave dhe brendimit që ndërgjegjëson stafin dhe pacientët për VMS-në
- Hartimi dhe printimi i një fletëpalosje për mirëmenaxhimin e vizitorëve
- Hartimi i pyetësorëve para dhe pas instalimit të VMS-së për matjen e kënaqësisë së pacientit/vizitorit dhe përmirësimin e vazhdueshëm

### QËLLIMI 8 - ORGANIZON FUSHATA PËR NGRITJE FONDESH

Objektivat:

- Hartimi i një liste me nevojat e SRK-së
- Ngritja e fushatave për ngritje fondesh për nevojat e spitalit
- Ndërgjegjësimi i shoqërisë civile dhe eksplorimi i mundësive për bashkëpunim
- Mbështet aktivitete të vazhdueshme të spitalit me fushata për ngritjen e fondeve

### QËLLIMI 9 - ZHVILLIM PROFESIONAL I PANELEVE KËSHILLUES PËR KËSHILLIM ME KOMUNITETIN

Objektivat:

- Krijimi i një fryme pranuese brenda Spitalit për Panelet Këshilluese me Komunitetin
- Përzgjedhja dhe pjesëmarrja e anëtarëve me përfaqësues të komunitetit.
- Krijimi i Panelit Këshilluese me Komunitetin
- Pjesëmarrje aktive dhe efektive e anëtarëve të spitalit dhe komunitetit në mbledhjet e caktuara.

### QËLLIMI 10 - FORCIMI I NJË KLIME RESPEKTI NDAJ DALLIMEVE RACIALE

Objektivat:

- Advokimi për krijimin e një kulture respekti të ndërsjelltë midis komunitetit dhe spitalit e cila duhet të zbatohet nga stafi, vizitorët, pacientët, personeli mjekësor dhe jomjekësor
- Promovimi i një ambienti të sigurt për punonjësit, pacientët, vizitorët dhe anëtarë të shoqërisë civile
- Mbështet programe respekti në bashkëpunim me të gjithë bashkëpunëtorët për të garantuar klimën e respektit reciprok

## SFIDAT

Spitalet janë simboli më i dukshëm i sistemit shëndetësor, sfidat kanë të bëjnë me ofrimin e një shërbimi cilësor, në kohën e duhur, brenda buxhetit dhe burimeve në dispozicion. Ne na duhet të jemi transparent dhe efiçient pasi ne jemi ata që përballemi me pacientët dhe komunitetin e rajonit

të Korçës. Është me një rëndësi të jashtëzakonshme për imazhin dhe mbarëvajtjen e punëve në SRK komunikimi i ndryshimeve dhe sfidave, komunikim ky në dy drejtime: komunikimi i brendshëm dhe komunikim i jashtëm. Ky plan komunikimi do të garantojë komunikimin në kohë dhe me sukses dhe ndryshimin e perceptimeve të komunitetit për SRK-në.




## AUDIENCA E BRENDESHME

- Drejtuesi i Spitalit Rajonal Korçë
- Drejtuesit e SRK
- Stafi i SRK – mjekësor dhe jo mjekësor
- Student/praktikantë
- Pacientë
- Vizitorë/familjarë

## AUDIENCA E JASHTME

- Ministria e Shëndetësisë
- ISKSH
- Qeveria Italiane
- Donatorë: si Njësite e Qeverisies Vendore (Bashki, Këshilli i Qarkut),
- Fondacionet Dorkas dhe Tabita, ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit), etj
- Mediat lokale – e shkruar dhe vizive
- Anëtarë të shoqërisë civile - Komuniteti i Korçës
- Senatet e shkollave të mesme

- Universitet
- Biznese që ofrojnë nënkontraktojnë shërbime joklinike

## KUSH, SI DHE KUR (FREKUENCA) KOMUNIKOHET ME AUDIENCËN E BRENDËSHME DHE TË JASHTME

### KOMUNIKIMI I BRENDËSHËM

| KUSH | SI DHE KUR | PËRFAQËSUES I SPITALIT |
|---|---|---|
| I gjithë stafi | Borde komunikimi në pavione, komunikime të vazhdueshme sipas nevojave | Drejtori i Spitalit apo i deleguari I tij |
| Shefat e Departamenteve | Mbledhjen e së hënës, mbledhje departamenti | Drejtori i Spitalit apo i deleguari I tij |
| Pacientët/komuniteti/vizitorë/familjarë | Fletëpalosje/ekrane elektronike në recepsione, postera, materiale të tjera komunikuese sipas nevojës për komunikim | Stafi i spitalit, administrata, përfaqësues të PR-së etj, sipas nevojës |
| Stafi | Sesione komunikimi, takime, evente, etj. | Drejtori i Spitalit apo i deleguari i tij, Shefat e Departamenteve etj. |
| Panelet këshilluese Qytetare | Takimet e planifikuara vjetore, komunikime me em, komunikime të tjera sipas nevojës | Drejtori i Spitalit apo i deleguari i tij, anëtarët e paneleve këshilluese qytetare të spitalit |

### KOMUNIKIMI I JASHTËM

| KUSH | SI DHE KUR | PËRFAQËSUES I SPITALIT |
|---|---|---|
| ISKSH | Takime të vazhdueshme, njoftime për shtyp dhe ftesa për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme | Drejtori i Spitalit apo i deleguari i tij |
| Donatorë | Takime të vazhdueshme sipas nevojës, njoftime për shtyp dhe ftesa për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme | Drejtori i Spitalit apo i deleguari i tij, personi i PR apo grupi i PR |
| Njësite e Qeverisies Vendore | Njoftime për shtyp dhe ftesa për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme, takime komitetesh të ndryshme etj | Drejtori i Spitalit apo i deleguari i tij, Shefat e Departamenteve, Personi i PR |
| Mediat lokale – e shkruar dhe vizive | Njoftime për shtyp dhe ftesa për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme, takime të ndryshme, intervista, artikuj, analiza vjetore, faqja zyrtare e SRK etj. | Drejtori i Spitalit apo i deleguari i tij, personi i PR. |
| Anëtarë të shoqërisë civile - Komuniteti i Korçës | Njoftime për shtyp dhe ftesa për pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme si ditët e hapura, takime të ndryshme si | Drejtori i Spitalit apo i deleguari i tij, anëtarët e paneleve këshilluese |

| | | |
|---|---|---|
| | paneli këshillues qytetar, faqja zyrtare e SRK, tabela komunikimi etj | qytetare të spitalit |
| Senatet e shkollave të mesme/ Universitet | Sesione komunikimi, takime, evente, etj. | Drejtori i Spitalit apo i deleguari litij, Shefat e Departamenteve, Personi i PR, anëtarët e paneleve këshilluese qytetare të spitalit |
| Biznese që janë nënkontraktuar për shërbime joklinike | Takime të vazhdueshme sipas nevojës, Sesione komunikimi, takime, evente etj | Drejtori i Spitalit apo i deleguari i tij, Shefat e Departamenteve, Personi i PR, anëtarët e paneleve këshilluese qytetare të spitalit |

## PLANI I PUNËS SË STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT 2013 - 2014

Detaje të të gjithë aktiviteteve të komunikimit të synuara me afate (deadline) dhe përgjegjësitë. Këtu janë përfshirë objektivat kyç dhe data rishikimi. Janë menduar kostot, përfirë stafin dhe asistencën që nevojitet, dhe sesi do të vlerësohet suksesi.

**Planet e komunikimit janë dokumenta "të gjallë" dhe duhet të rishikohen e rinovohen në mënyrë të vazhdueshme.**

| Objektivi | Aktiviteti | Koha kur do të zbatohet aktiviteti | | | | Indikatorët për matjen e aktivitetit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Q1* | *Q2* | *Q3* | *Q4* | |
| 1) Zhvillimi i Një Kulture Të Shërbimit Cilësor | Monitorimi i aplikimit të standarteve të Higjenës së duarve | X | X | X | X | Numri i takimeve informuese, kontrolleve, forme monitorimi, numri i trainimeve. |
| | Organizimi i ditëve të hapura | | | | | |
| | Promovimi i shembujve pozitive si staf ashtu dhe shërbime, raste suksesi në mediat lokale | X | X | X | X | |
| 2)OFRIMI I NJË SHËRBIM CILËSOR PCIENTËVE DHE KOMUNITETIT TË RAJONIT KORÇË | Hartimi i një pyetësori që vlerëson kënaqësinë e pacientit | X | | | | |
| | Promovimi lipyetësorit me | | X | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | anë të mjeteve të komunikimit (postera, pjesëmarrje në TV show TV/radio locale, artikuj në gazetën lokale | | | | | |
| | Krijimi i procedurave për të gjithë procesin e monitorimit të pyetësorëve të kënaqësisë së pacientit (personat përgjegjës, shpërndarja, mbledhja e informacionit, frekuenca, dhe drejtimi i ankesave tek personat/departamentet përkatëse, analizimi zgjidhja e problematikave dhe informimi i pacientëve mbi zgjidhjet e dhëna) | X | | | | Numri i personave të informuar për proçesin. |
| | Vendosja e pyetësorit në faqen zyrtare të SRK | X | | | | Faqja zyrtare e SRK: www.srk.gov.al Numri i personave që kanë plotësuar pyetësorin online. |
| | Bërja e pyetësorit të aksesueshëm nga smartphone | X | | | | Numri i personave që kanë plotësuar pyetësorin online. |
| | Monitorimi i vazhdueshëm i shpërndarjes së pyetësorit | X | X | X | X | Numri i takimeve. Numri i problematikave të ngritura dhe/ose zgjidhura |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Bashkëpunimi me PAO | | | X | X | Numri i personave të përfshirë. |
| | Hartimi dhe zbatimi i setit të Standarteve të Kujdesit ndaj pacientit | X | X | X | X | Numri i standarteve të zbatuara |
| | Përgatitja dhe shpërndarja e një Guide "Shërbimi i Ekselencës – Standartet e Sjelljes – Spitali Rajonal Korçë". Kjo guidë do të shërbejë si referencë për çdo punonjës | | | X | X | Numri i personave që janë informuar. |
| 3)SPITALI RAJONAL KORÇË TË BËHET NJË VEND PUNE QËPROMOVON VLERA | Krijimi i një pyetësori për kënaqësinë e punonjësit dhe analizimi i të dhënave | | | | X | |
| | Forcimi dhe mbështetja, promovimi i trainimeve | X | X | X | X | Numri i trainimeve |
| 4)PROMOVIMI I SITEMEVE TË INFORMACIONIT | Mbështet planin e implementimit të sistemit të informacionit | | | | | Ndjekje rigoroze e planit të informimit të VMS –SRK. |
| | Mban punonjësit të informuar mbi rëndësinë dhe forcon marrëdhëniet me dy spitalet e tjera pilote SRL dhe SUOGJ | X | X | X | X | Numri/lloji i materialeve komunikuese të përdoruara. |
| | Punon për promovimin e rezultateve positive në | X | X | X | X | Numri/lloji i mediave të përdorura. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | mediat locale sesi kompiuterizimi I të dhënave të pacientëve përmirëson aksesin dhe cilësinë e shërbimit | | | | | |
| 5)RRITJA E STANDARTEVE TË HIGJENËS DHE PASTËRTISË NË SPITAL DUKE MBËSHTETUR DHE PROMOVUAR NJËSINË E SHËRBIMEVE MJEDISORE | Dizenjimi/prodhimi/shperndarja e materialeve komunikuese brenda SRK | X | X | X | X | Numri/lloji i materialeve komunikuese të përdoruara. |
| | Organizimi i seancave të informimit dhe trainimi | X | X | X | X | Numri/lloji i materialeve komunikuese të përdoruara. |
| | Promovon rezultateve pozitive në mediat lokale | X | X | X | X | Numri/lloji i mediave të përdorura. |
| 6)RRITJA E AFTËSIVE KOMUNIKUESE TË STAFIT MES KOLEGËVE, KOMUNIKIMIN OFRUES SHËRBIMI – PACIENT DHE/OSE VIZITOR DHE KOMUNIKIMIN ME KOMUNITETIN NË TËRËSI | Trainimi i TOT | X | | | | Numri i personave të trainuar |
| | Pregatitja e moduleve për trainimin e stafit të SRK | | X | | | Numri i moduleve trainuese |
| | Trainimi i stafit të spitalit në lidhje me parimet e kujdesit ndaj klienit/pacientit | X | X | X | X | Numri i personave të trainuar |
| | Hartimi dhe zbatimi i setit të Standarteve të Kujdesit ndaj pacientit | X | X | X | X | Numri i standarteve të zbatuara |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 7)ORGANIZON FUSHATAT E INFORMIMIT PËR MIRËMANAXHIMIN E VIZITORËVE | Hartimin dhe zbatimin e një plani të detajuar për të mbështetur funksionimin e suksesshëm të sistemit të mirëmenaxhimit të vizitorëve | X | | | | Concept paper |
| | Informimin e brendshem të stafit me anë të sesioneve informuese/ mbledjeve të stafit, emaileve/sms etj | X | X | | | Numri/lloji i komunikimeve të përdorura |
| | Trainimi e stafit për funksionimin e VMS dhe Etikën e Komunikimin | X | X | | | Numri/lloji i trainimeve. Numri i personave të trainuar |
| | Informimin e pacientëve dhe komunitetit | X | X | | | Numri/lloji i materialeve komunikuese të përdoruara. |
| | Hartimi dhe printimi i një fletëpalosje për mirëmenaxhimin e vizitorëve | X | X | X | X | Sasia e fletëpalosjeve të prodhuara dhe shpërndara |
| | Hartimi i pyetësorëve para dhe pas instalimit të VMS për matjen e kënaqësisë së pacientit/vizitorit dhe përmirësimin e vazhdueshëm | X | X | | | Numri i pyetësorëve |
| 8) ORGANIZON FUSHATA PËR NGRITJE FONDESH | Hartimi i një liste me nevojat e SRK | X | | | | Listë |
| | Hartimi i një liste me | X | X | | | Listë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | partnerë potencialë dhe vendosja e urave të komunikimit | | | | | |
| | Ndërgjegjësimi i shoqërisë civile dhe eksplorimi i mundësive për bashkëpunim | X | X | | | Numri i bashkëpunimeve të iniciuara |
| | Mbështet aktivitete të vazhdueshme të spitalit me fushata për ngritjen e fondeve | X | X | | | Numri/lloji i materialeve komunikuese të përdoruara. |
| 9)ZHVILLIM PROFESIONAL I PANELEVE KËSHILLUES PËR KËSHILLIM ME KOMUNITETIN | Krijimi i një fryme pranuese brenda Spitalit për gjetjen e urava të bashkëpunimit me Panelet Këshilluese me Komunitetin | X | | | | Listë |
| | Përzgjedhja dhe pjesëmarrja e anëtarëve më përfaqësues të komunitetit. | X | X | | | Listë |
| | Krijimi i Panelit Këshilluese me Komunitetin | X | X | | | Numri i bashkëpunimeve të iniciuara me PLPG |
| | Pjesëmarrje aktive dhe efektive e anëtarëve të spitalit dhe komunitetit në mbledhjet e caktuara. | X | X | | | Numri i takimeve. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10) FORCIMI I NJË KLIME RESPEKTI NDAJ DALLIMEVE RACIALE | Advokimi për krijimin e një kulture respekti të ndërsjelltë midis komunitetit dhe spitalit e cila duhet të zbatohet nga stafi, vizitorët, pacientët, personel mjekësor dhe jomjekësor | X | X | X | X | Numri i standarteve të Kujdesit ndaj Klientit të zbatuara me sukses |
| | Promovimi i një ambienti të sigurt për punonjësit, pacientët, vizitorët dhe anëtarë të shoqërisë civile. | X | X | X | X | |
| | Mbështetet programe respekti në bashkëpunim me të gjithë bashkëpunëtorët për të garantuar klimën e respektit reciprok | X | X | | | Numri i programeve të iniciuara |